

Raport i monitorimit të Kuvendeve të Komunave të Regjionit të Prizrenit

Mars 2014

Qëllimet e Monitorimit

KDI për të adresuar interesat dhe brengat të qytetarëve në mënyrë të paanshme dhe apatiake u ofron qytetarëve informata në mënyrë të vazhdueshme. Synimi i monitorimit të punës së zyrtarëve të zgjedhur është ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme demokratike.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve të zgjedhur janë:

- o Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- o Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- o Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- o Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- o Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- o Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- o Që zyrtarëve të zgjedhur t’iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- o Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për

Përmbajtja:

I. Përmbledhje nga kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit

- o Numri i mbledhjeve
- o Përmbledhja nga seancat
 - Prizren
 - Suharekë
 - Rahoveci
 - Malishevë
 - Dragash
 - Mamushë


II. Raportimet Financiare në Kuvendin e Komunës për vitin fiskal 2013

III. Shpenzimet enorme të komunës së Prizrenit në disa kategori buxhetore

Përmbledhje nga kuvendet e komunave të Regjionit të Prizrenit

- **Numri i mbledhjeve**

Gjatë muajit mars 2014, të gjitha kuvendet e komunave të regjionit të Prizrenit kanë realizuar aktivitete duke thirr seanca të jashtëzakonshme dhe mbajtur seanca të rregullta në marrjen e vendimeve të caktuara dhe me interes për publikun e gjerë.



Kuvendi i Komunës së Prizrenit, Suharekës gjatë muajit mars 2014 kanë thirr nga dy seanca, derisa Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka thirr dy seanca të jashtëzakonshme ai i Suharekës ka thirr një të jashtëzakonshme dhe një të rregullt derisa kuvendi i komunës së Malishevës, Rahovecit, Dragashit dhe Mamushës gjatë kësaj periudhe kanë thirr dhe mbajtur nga një seancë të rregullt.

Përmbledhja nga seancat

Në kuadër të monitorimit të punës së kuvendeve të komunave të Regjionit të Prizrenit, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ka vazhduar me monitorimin e punës së këtyre institucioneve edhe gjatë muajit mars 2014.

- **Prizren**

Gjatë muajit mars, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka thirr dy seanca dhe dyja kanë qenë të thirrura si të jashtëzakonshme. Në seancën e parë të thirrur si të jashtëzakonshme (12.03.2014) seancë kjo me pikë të vetme të rendit të ditës: shqyrtimi propozimit për shpalljen e z. Abdukkah bin. Zayed-bin.Sultan Al-Nahyan, Ministër i Punëve të Jashtme të Emirateve të Bashkuara Arabe, Qytetar Nderi i qytetit të Prizrenit.

Bazuar në nenin 44.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale lidhur me takimet e jashtëzakonshme të kuvendit të komunës i cili thotë se “Takimi i jashtëzakonshëm i kuvendit të komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga, më së paku, një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës, apo me kërkesë të kryetarit”.

E drejta për të thirrur një takim të jashtëzakonshëm gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar. Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes. Takimi i jashtëzakonshëm i kuvendit të komunës nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim, siç kërkohet me rregulloret e punës, së paku tri (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit¹.



Seanca e jashtëzakonshme është thirr me datë 10.03.2014 andaj mbajtja e kësaj seanca me datë 12.03.2013 është shkelje e nenit 44 të LVL-së. Pos shkeljes së këtij neni me rastin e mbajtjes së kësaj seance, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bashkë me Kryetarin e Komunës kanë shkelur edhe nenin 43.3 paragrafi E i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe nenin 44.5 i cili thotë se “anëtarët e kuvendit të Komunës duhet të pajisjen me materialet përcjellëse për rend dite”² për shkak të mungesës së materialit përcjellës për këtë seancë.

¹ Neni 44 I Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/efd1b00c-21b5-4070-987c-58f2fe814155/Ligji-per-Veteqeverisje-Lokale.aspx>

² Neni 43.3 paragrafi E i LVL-së, <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/efd1b00c-21b5-4070-987c-58f2fe814155/Ligji-per-Veteqeverisje-Lokale.aspx>

Kryetari i Komunës së Prizrenit z.Ramadan Muja, ka potencuar se ky propozim ka motivacion kontributin e sheikut Abdullah për angazhimet e tija që Kosova të njihet nga shumë shtete të Botës derisa anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prizrenit nga radhor e LVV-së kanë thanë se nuk janë kundër këtij propozimi, por shprehen vërejtjet e tyre se cili ka qenë kontributi i ministrit Al Najhan, për qytetin dhe qytetarët e Prizrenit.

Më pas me 29 vota për, 2 kundër dhe 2 abstenime, është miratuar ky propozim derisa në këtë seancë kanë munguar anëtarët e Kuvendit të Komunës nga radhët e Bashkimit Demokratik.

Në seancën e dytë të thirrur si të jashtëzakonshme (26.03.2014) seancë kjo me pikë të vetme të rendit të ditës: gjendja aktuale në Kuvendin Komunal të Prizrenit, pas vendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, për shpallje fajtorë të Kryetarit Muja dhe pesë zyrtarëve të lartë komunal dhe vetë-pezuillimit të detyrës së kryetarit të Komunës së Prizrenit.

Kjo seancë e jashtëzakonshme është thirrë nga nënshkruer të kërkesës përkatësisht nga grupi i këshilltarëve të opozitës: LDK, BD, VV dhe Partia Konservatore, parti këto të përfaqësuara në kuvendin e komunës së Prizrenit.

Pas hapjes së seancës nga ana e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, shefi i grupit parlamentar të PDK-së ka lexuar një deklaratë e cila ishte në mbështetje të vazhdimin të punës së Kryetarit të Komunës së Prizrenit deri në përfundimin e procesit të anketimit përkatësisht shfrytëzimin e mjeteve

juridike që ja garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kjo deklaratë është lexuar në emër të subjekteve të koalicionit qeverisës PDK, AAK/LDD, VAKAT, NDS, KDTP, KTAP, CDU.

Pas leximit të deklaratës, subjektet pozitare përkatësisht subjektet në koalicionin qeverisës kanë lëshuar mbledhjen. Pas lëshimit të mbledhjes së kuvendit nga subjektet pozitare, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit ka specifikuar numrin e anëtarëve të pranishëm ku nga 41 anëtarë, në seancë kanë mbetur vetëm 17, dhe nga kryesuesi është mbyllur seanca në mungesë të kuoromit.

Subjektet opozitare kanë vazhduar edhe pas ndërprerjes së seancës nga Kryesuesi për shkak të mungesës së kuoromit, duke shprehur pakënaqësitë në mungesën e gatishmërisë së Kryetarit të Komunës së Prizrenit që të jep dorëheqje dhe të mos vazhdojë me qeverisje komunën e Prizrenit tanimë më me një vendim të gjykatës themelore për shpërdorim të detyrës zyrtare.

KDI konsideron se “bojkoti i seancës nga këshilltarët e opozitë është papërgjegjësi institucionale ndaj qytetarëve. Nuk është hera e parë që kjo ndodhë në Prizren, ku pozita ikën, duke mos pasur gatishmëri që të ballafaqohet me situatën e krijuar pas aktgjyqimit të Gjykatës Themelore që e ka shpallur fajtorë Kryetarin e Komunës për abuzim të detyrës zyrtare. Po ashtu konsideron se Kryesuesi i Kuvendit të Komunës nuk është dashur që ta ndërpriste seancën pas largimit të pozitës për arsye se “seanca është thirr si e jashtëzakonshme dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale precizon se kuorumi verifikohet vetëm para marrjes së vendimit”.

Kuorumi për të gjitha takimet e kuvendit të komunës dhe komiteteve të tij është së paku gjysma e numrit të anëtarëve të Kuvendeve Komunale. 46.2 Kuorumi duhet të verifikohet para çdo vendimi të marrë³.

- **Suharekë**

Gjatë muajit mars 2014, Kuvendi i Komunës së Suharekës ka thirrur dy seanca, njëra nga të cilat ka qenë seance e thirrur si e jashtëzakonshme dhe tjetra ka qenë e thirrur si seancë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Suharekës.

Në seancën e parë e thirrur si e jashtëzakonshme (12.03.2014) ku ish-in paraparë të shqyrtoheshin dy pika për rendit të ditës: miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dhe shqyrtimi i projekt vendimit për iniciimin e procedurës për ndryshimi të pjesshëm të PZHU-së të qytetit të Suharekës.

Pika e parë e rendit të ditës miratohet unanimisht nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Suharekës.

Pika e dytë e rendit të ditës rreth shqyrtimit të projekt vendimit për iniciimin e procedurës për ndryshim të pjesshëm të PZHU të qytetit të Suharekës.

³ Neni 46.1 dhe 46.2 I Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/efd1b00c-21b5-4070-987c-58f2fe814155/Ligji-per-Veteqeverisje-Lokale.aspx>

Fillimisht lidhur me këtë pikë të rendit të ditës z.Sali Asllanaj ka elaboruar kërkesën e Shoqatës “Shpresimi” kërkesë kjo e drejtuar autoriteteve lokale për ndarjen e një lokacioni në shfrytëzim (pronë e komunës) për varrosjen e anëtarëve të familjes Berisha të vrarë gjatë luftës 98-99.

Pas shqyrtimit të kërkesës Kryetari i Komunës ka angazhuar DUPM që urgjentisht ta shqyrtoj lëndën. DUPM ka analizuar Planin Zhvillimor Urban ku dhe ka verifikuar lokacionin e kërkuar nga ana e parashtruesit të kërkesës. Ky lokacion sipas PZHU është me destinim hapësirë me përmbajtje publike (instituticion kulturor dhe fetar). Për realizimin e kërkesës në radhë të parë është e nevojshme që të iniciohen procedurat për ndryshim të pjesshëm të Planin Zhvillimor Urban duke ndryshuar destinimin nga ai paraprak në hapësirë e veçantë/Varreza. Sipërfaqja e cila kërkohet të shfrytëzohet është 2180 m², sipërfaqja e përgjithshme e parcelës kadastrale nr.806/2, ZK Suharekë, pasuri publike në emër të Komunës së Suharekës.

Për këtë çështje, përmes zyrës së Kryetarit, është ftuar Këshilli i Eksperteve për Planifikim në nivel komunal për ta dhënë rekomandimin e tyre rreth kërkesës në fjalë. Këshilli i Eksperteve në takimin e mbajtur me datë 24.02.14 nuk është pajtuar për ndryshim destinimin e Planin Zhvillimor Urban. Duke u bazuar në këtë rekomandim, Kryetari i Komunës i është përgjigjur parashtruesit të kërkesës.

-Duke parë këtë situatë të ndjeshme, Kryetari i Komunës së Suharekës ka proceduar me kërkesë që të iniciohet ndryshimi i Planit Zhvillimor Urban (PZHU) me qëllim të ndërrimit të

destinimit të pronës së kërkuar nga Shoqata “Shpresimi” nga ai paraprak në hapësirë të veçantë/Varreza.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës në mënyrë unanime kanë dhënë dritën e gjelbër inicimit të ndryshimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) të Suharekës.



Seanca e dytë e thirrur si e rregullt nga Kuvendi i komunës së Suharekës (28.03.2014), ku ishin parapri të trajtoheshin këto çështje: dhënia e deklaratës së betimit anëtarëve që janë zëvendësuar; miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; shqyrtimi i projekt vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-16-240, të datës 15.01.2014; shqyrtimi i projekt vendimit për formimin e komisionit për emërtimin e zonave të qarkullimit publik; shqyrtimi i projekt vendimit për miratimin e planit të punës vjetor për vitin 2014, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB); shqyrtimi i raportit mbi administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2013; shqyrtimi i projekt vendimit për transferimin (bartjen) e mjeteve nga kategoria ”investimet kapitale” në kategorinë “Mallra e Shërbime” sipas programeve ekonomike për vitin 2014 dhe syetje dhe përgjigje.

Fillimisht dy nga anëtarët e rinj kanë dhënë betimin në Kuvendin e Komunës së Suharekës. Nga LDK ka dhënë

betimin znj. Florie Bytyçi pas dorëheqjes së znj. Luljeta Baraliu si dhe Jetmir Zeqiri nga PDK i cili ka zëvendësuar Murtez Zekollin.

Shqyrtimi i projekt vendimit për ndryshim e vendimit 01-Nr-16-240 të datës 15.01.2014 kishte të bënte rreth ndryshimit të emrave të anëtarëve të cilët janë përzgjedhur që të jenë pjesë e Komitetit për Politikë dhe Financa, ndryshime këto të cilat janë ardhur si rezultat i dorëheqjes së disa anëtarëve që kanë marrë besimin e qytetarëve të përfaqësohen në këtë institucion.

Pika e katërt e rendit të ditës e cila kishte të bënte rreth shqyrtimit të projekt vendimit për formimin e Komisionit për emërtimin e zonave të qarkullimit publik kaloi me debate tek anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës. Fillimisht ky komision është propozuar që në vetë ti ketë tre anëtarë mirëpo nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Suharekës është propozuar që ky komision ti ketë në vete pesë (5) anëtarë.

Si anëtarë të këtij Komisioni janë propozuar: Reshat Selimaj (AAK), Halil Morina (LDK), Zana Basha (LVV), Agim Bujrai (PDK) dhe Abdullah Krasniqi nga Shoqëria Civile dhe është miratuar me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm në këtë seancë. Si detyrë e këtij komisionit është të përgatis dhe përcjell procesin e emërtimit të zonave të qarkullimit publik në tërë territorin e Komunës së Suharekës, nëpër të gjitha fazat.

Pika e pestë e rendit të ditës e cila kishte të bënte rreth shqyrtimit të projekt vendimit për miratimin e Planit të punës vjetor për vitin 2014, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi u miratua nga ana e anëtarëve të Kuvendit të

Komunës së Suharekës mirëpo edhe në këtë Plan të Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) i janë dhënë vërejtje dhe sugjerime nga ana e anëtarëve të kuvendit. Sipas qëndrimit të AAK-së ky Këshillë është në kundërshtim me dispozitat ligjore ngase nuk janë marrë për bazë specifikat se kush nga anëtarët duhet të jetë prezent në këtë këshillë.

Rreth pikës së gjashtë të rendit të ditës e cila kishte të bënte rreth shqyrtimi të raportit mbi administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2013, zgjoi debat dhe kundërshti ndërmjet pozitës dhe opozitës përkatësisht udhëheqësit aktuale të komunës së Suharekës (LDK) dhe ish udhëheqësit së kësaj komune (AAK).

Derisa anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës nga radhët e AAK-së mbronin qëndrimin se ish ekzekutivi i komunës së Suharekës nuk ka borxhe dhe borxhet e specifikuar nuk janë veçse kontrata dy apo tri vjeçare të lidhura me Operatorët Ekonomikë për realizimin e investimeve kapitale por edhe të atilla për shërbime dhe mallra. Anëtarët tjerë të Kuvendit të Komunës së Suharekës kundërshtojnë formën e shpenzimeve të parasë publike gjatë vitit ta kaluar, e udhëhequr nga z. Blerim Kuqi duke aluduar në shpenzimet enorme dhe pa kriter dhe në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Përplasjet ndërmjet AAK-së dhe anëtarëve tjerë të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës së Suharekës, bënë që Kuvendi i Komunës së Suharekës të themelojë një Komision mbi verifikimin e situatës financiare dhe pasqyrimin e saktë të borxheve të ish pushtetit komunal të komunës së Suharekës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës kanë propozuar të formohet një Komision nga ky institucion me qëllim të verifikimit të të gjitha borxheve që ka komuna e Suharekës andaj me 19 vota për, 7 kundër dhe 2 abstenime është votuar pro marrjes së vendimit për themelimin e këtij komisioni dhe që ky komision të jetë pese (5) anëtarësh.

Në përbërjen e këtij Komisioni janë emëruar: Luljeta Baraliu (LDK), Murtez Zekolli (PDK), Lonorad Shala (LVV), Bajram Tërshana (PD) dhe Arjan Zenelaj (AAK) ku me 20 vota pra 1 abstenim është miratuar me këtë përbërje Komisioni për Verifikimin e borxheve të komunës së Suharekës.

Pika e tetë e rendit të ditës e cila kishte të bënte rreth shqyrtimit të projekt vendimit për transferimin (bartjen) e mjeteve nga kategoria "investimet kapitale" në kategorinë "Mallra e Shërbime" sipas programeve ekonomike për vitin 2014 u miratua nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Suharekës.

Sipas këtij projekt vendimi, Komuna e Suharekës gjatë vitit 2013, ka pasur obligime të pa paguara në kategorinë "**mallra dhe shërbime**" në vlerë prej **265,840.00** Euro dhe në pamundësi që këto obligime të kryhen nga buxheti i planifikuar për vitin fiskal 2014, nga kategoria "**mallra dhe shërbime**" jemi të detyruar që mjetet ti sigurojmë duke i zvogëluar ato nga kategoria e "investimeve kapitale" të vitit 2014 dhe atë nga **Fondi Burimor Qeveritar (10) vlerën prej 221,580.00 Euro** dhe mjetet tjera nga të hyrat vetanake, **Fondi Burimor (21) në**

vlerë prej **44,260.00E**, që në total është **(221,580,00+44,260.00)=265,840.00 E**.

Mjetet nga kategoria "Investimeve kapitale" të viti 2014, do të lejohen për alokim, sipas nenit 1, dhe nenit 2, të këtij vendimi në kategorinë "mallra dhe shërbime" që janë të evidentuar dhe të paraparë për kryerjen e obligimeve të vitit 2013

Në pikën e fundit pyetje dhe përgjigje nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Suharekës janë ngritur disa çështje dhe ndër me të spikatura ishin: shqetësim lidhur me përdorimin e drogës nga nxënësit e shkollave të mesme në të Suharekës, ndërmarrja e veprimeve adekuate për rikthimin e pronës së stacionit të autobusëve, përmbajtja e lejes së ndërtimit në ndërtimin e banesës kolektive 12 katërshe etj.

- **Malishevës**

Kuvendi i komunës së Malishevës ka mbajtur seancën e saj të rregullt (**21 mars 2014**) në të cilën ka trajtuar këto çështje; shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, deklarime jashtë rendit të ditës, pyetje nga anëtarët e Kuvendit për drejtoret e drejtorive Komunal, formimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, prezantimi i qeverisë Komunale dhe prezantimi i programit qeveritar dhe lista e projekteve kapitale, shqyrtimi dhe miratimi i propozim Planit të punës së Kuvendit për vitin 2014, shqyrtimi dhe miratimi i draft Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2014, miratimi i kërkesës për destinimin e të hyrave të bartura nga viti 2012 dhe 2013, në vitin fiskal 2014, raporti i punës së DKAE-së, për vitin 2013/14 dhe të ndryshme.

Së pari, me të filluar seanca e kanë dhënë betimin dy anëtarët e rinj nga radhët e PDK- së, të cilët kanë zëvendësuar Adem Berishën dhe Merita Krasniqin, të cilët kanë vendosur që ta lënë mandatin e të qenit anëtarë të kuvendit për arsye të mbajtjes së pozitive në sektorin publik.

Fillimisht jashtë rendit të ditës anëtari i Kuvendit të Komunës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje z.Muhamet Bytyqi ka bërë një paraqitje publike në kuvend rreth kërcënimeve që siç tha ai kishte marrë me dt 2 mars 2014 nga Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim z.Ahmet Morina, në lidhje me inicimin e hetimeve të një procesi kundër kryetarit të komunës, rast ky i cili është raportuar edhe në polici, si dhe kërkesën që ata kanë dërguar tek MAPL-ja në lidhje me mbajtjen e pozitës së dyfishtë nga anëtari i IQM-së Nuhi Shala i cili është zgjedhur edhe drejtor i një kompanie publike.



Në këtë seancës të Kuvendit të Komunës fjalën e mori edhe Shefi i Zyrës Rajonale së OSBE-së në Prizren, z. Ulrich Biffar, ku gjatë adresimit ka uruar anëtarët e ri të kuvendit komunal duke theksuar bashkëpunim të mire midis OSBE-së dhe komunës, ai gjithashtu theksoi se “OSBE-ja do të vazhdon me përkrahjen për komunën”. Në fund ai ja dhuroi kryesuesit të kuvendit, z.Enver Hoti, një mirënjohje për bashkëpunim të mirë me OSBE-në.

Gjatë kësaj seance pati edhe propozime për ndryshim të rendit të ditës, Muhamet Bytyqi nga LVV kërkoi që të formohet një komision për vlerësimin e Projekteve elektorale siç i quajti ai përgjatë vitit 2013 të realizuara nga qeveria komunale si dhe të hiqet nga rendi i ditës rregullorja për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale, propozime këto të cilat nuk hasën në mbështetje të anëtarëve të kuvendit për të hyrë në rend të ditës.

Ndërsa Januz Kastrati (LDK) ka propozuar që për mungesë të materialit të duhur të hiqet nga rendi i ditës raporti i drejtorit të DKA-së, kërkesë kjo e përkrahur edhe nga PDK-ja, ndërsa nga pika e pestë kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës lista e projekteve kapitale, ndërsa që të hyjë në rend të ditës pika për themelimin e komisionit të Aksionarëve si dhe të formohet komisioni për ndryshimin e Statutit të komunës së Malishevës.

Me shumicë të votave, 28 për dhe 1 kundër u vendos që të hyjë në rend të ditës pika për themelimin e komisionit të Aksionarëve të komunës së Malishevës si dhe të formohet komisioni për ndryshimin e Statutit të komunës së Malishevës, deri sa u vendos që të hiqet nga rendi i ditës raporti i Drejtorisë Komunale të Arsimit.

Me vërejtje dhe sugjerime është miratuar pika e parë e rendit të ditës procesverbali nga seanca e kaluar, votimi ishte unanim.

Pika e dytë me radhë që pati të bëjë me pyetje nga anëtarët e Kuvendit për ekzekutivin e komunës së Malishevës, në lidhje me disa shqetësime që kishin ata, e që kryesisht kishin të bënin me përmirësimin e cilësisë në arsimin Malishevas,

mosrespektimi i kritereve në realizimin e projekteve të komunës në fushën e infrastrukturës, konkursi i fundit për drejtorët e shkollave në lidhje me kriteret e për përzgjedhjen e tyre, problemet e infrastrukturës në disa fshatra si kanalizimi, rruga, uji i pijes e deri tek ndotja e ambientit.

Ndërsa pika e tretë me radhë, në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Udhëzimit Administrativë nr.27/2012 të MPB-së, në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, rekomandimet që kanë dalë nga mbledhja e fundit e KPF-së si dhe me kërkesë të kryetarit të komunës, kuvendi i komunës së Malishevës ka marrë vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Ky këshill i cili është formuar në bazë të procedurave të rregullta ku gjatë kësaj seance janë propozuar të gjithë 15 emrat e anëtarëve të këtij këshilli. Vërejtje tek përfaqësuesi i OJQ-ve, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuar, paraqiti anëtari i Vetëvendosjes Muhamet Bytyqi i cili sugjeroi që në këtë përbërje kishte me qenë mirë të jetë njëri nga tre përfaqësuesit e gazetarëve të komunës së Malishevës të cilët edhe do ta pasqyronin punën e këtij këshilli në mënyrë të duhur. Votimi 14 për 5 kundër.

Në pikën e katërt me radhë kryetari i komunës së Malishevës z.Ragi Begaj, me kërkesën e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, ka prezantuar para tyre përbërjen e qeverisë komunale, programin qeverisës dhe projektet kapitale. Në pika të shkurta ai bëri prezantimin e ekzekutivit të komunës (drejtorët e zgjedhur), si dhe programin e qeverisë së tij ku si

prioritete të qeverisë së tij përmendi përmirësimin e gjendjes së arsimit, zhvillimin e bujqësisë, infrastrukturën lokale, përballjen me problemin e rriqrave etj.

Ai po ashtu i prezantoi edhe disa nga projektet më të rëndësishme që do të realizohen përgjatë vitit 2014, ku përveç së paku pesë shkollave, planifikohen edhe ndërtimi i katër rrugëve të reja, ujësjellësi për fshatin Drenoc dhe fshatrave tjera, përfundim të kanalizimeve, investime në bujqësi, angazhim maksimal kundër etheve hemorragjike dhe të tjera. Si kundërpërgjigje ndaj këtyre çështjeve anëtarët e kuvendit të komunë ia përkujtuan kryetarit disa nga premtimet që ai i kishte bërë gjatë fushatës elektorale 2013 si dhe ia paraqitën një numër shqetësimeve të banorëve dhe kërkesave që kanë disa nga fshatrat e kësaj komune.

Pika e pestë me radhë shqyrtimi i propozim Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2014, i paraqitur në bazë të punës së komisionit, ku për hartimin tij ishte formuar një komision i përbërë nga anëtarët e kuvendi në të cilin janë përfaqësuar të gjitha subjektet politike. Me disa vërejtje si ajo e anëtarit të LVV-së që në këtë plan të punës diku ka muaji majë të jetë në rend të ditës trajtimi i problemit të rriqrave. Kjo pikë e rendit të ditës është votuar në mënyrë unanime.

Pika që ngjalli më së shumti debat tek anëtarët e kuvendit të komunës së Malishevës ishte ajo rreth shqyrtimit të draft Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba Komunale për vitin 2014. Sipas disa rekomandimeve që kishin dalë nga KPF-ja, dhe propozim të ekzekutivit, për lirim nga taksa komunale

për vitin 2014 për të gjitha bizneset të cilat operojnë në komunën e Malishevës.

Januz Kastrati (LDK) kërkoi sqarime nga drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa të sqaroj se si do të kompensoheshin të hyrat e komunës pasi që kjo do të heqë taksat bizneseve, si dhe mjaftë shqetësuesi paraqiti faktin e shumës tejte të lartë të borxheve të pa mbledhura nga ana e komunës, si dhe të verifikohen të hyrat e komunës nga arsimi.

Ndërsa Muhamet Bytyqi (LVV) propozoi që për disa kategori si certifikatat e lindjes, vdekjes etj duhet tu hiqet pagesa për to, si dhe në heqjen e taksës komunale mos të përfshihen bizneset si bankat, kompanitë si KEK-u, KEDS-s etj.

Derisa Avdi Morina nga (IQM) bëri thirrje që të përkrahet propozimi për heqjen e taksës komunale bizneseve si formë e përkrahjes së tyre, si dhe deklaroi se edhe ai vet është kundër heqjes së taksës komunale sidomos bankave. Me vendimin për heqjen e taksë komunale për bizneset për vitin 2014, dhe pa ndonjë ndryshim të theksuar nga ajo e vjetra është miratuar kjo rregullore. Ky vendim është përkrahur nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Malishevës dhe me 15 vota për dhe 1 kundër aprovohet si i tillë.

Derisa pika e shtatë e rendit të ditës ka pas të bëjë me riridestimin e të hyrave dhe të barturat 2012-13 në vitin fiskal 2014. Pas përfundimit të vitit fiskal 2013 në fondin 21 dhe 22 të të hyrave vetanake kapin shumën prej 155,898,27 euro, shumë kjo e cila do të bartet në vitin fiskal 2014, dhe që është paraparë të shpenzohet në projektin e ujësjellësit për fshatit

Drenoc, projekt ky i cili do të bëhet me bashkëfinancim nga komuna e Malishevës dhe Donatorët. Kjo pikë e rendit të ditës është votuar në mënyrë unanime nga anëtarët prezentë në këtë seancë.

Në pikën e tetë të rendit të ditës u mor vendim për funksionalizimin e komisionit të aksionarëve të Komunës së Malishevës, komision ky i cili në bazë të ligjit ka qenë i formuar edhe në legjislaturën e kaluar mandati i së cilës ka qenë i njëjtë me atë të anëtarëve të kuvendit. Me 24 vota për dhe 1 abstenim është vendosur që anëtarë të komisionit të aksionarëve të Komunës së Malishevës të jenë: Januz Kastrati (LDK) dhe Hafir Rexha (AKR)

Po ashtu në këtë mbledhjen u mor vendim edhe për formimin e komisionit për ndryshimin e statutit të Komunës së Malishevës, komision ky i cili do të përbëhet nga tetë anëtar, gjashtë nga të cilët do të jenë nga subjektet politike të përfaqësuara në kuvend, një ekspert nga jashtë dhe do të udhëhiqet nga kryesuesi i kuvendit të komunës së Malishevës z.Enver Hoti. Edhe ky propozim vendim i Kuvendit të Komunës së Malishevës u përkrahë në mënyrë unanime nga anëtarët prezentë në këtë seancë.

Ndërsa tek pika e dhjetë e rendit të ditës dhe e fundit me radhë, të ndryshme anëtari i PDK-së Ahmet Rrahmanaj kërkoi që të nisin procedurat për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave.

- **Rahovec**

Gjatë periudhës raportuese Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka mbajtur një seancë (28.03.2014) gjatë së cilës ka trajtuar: aprovimi i procesverbaleve nga mbledhja e datës 13.02. dhe 26.02.2014, informatë mbi obligimet financiare të faturuara dhe të pa-faturuara, shqyrtimi i propozimit të komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës së Rahovecit, themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, formimi i Komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve, formimi i komisionit për ndarje të bursave,



shqyrtimi dhe aprovimi i projektvendimit për krijimin e të drejtës së servitutit në pronësi komunales shqyrtimi i propozim vendimit për aprovimin e projektit teknik për zgjerimin e sistemit të ujitjes në disa fshatra të komunës së Rahovecit dhe pyetjet e këshilltarëve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Rahovecit , para fillimit me rendin e ditës kërkoj nga Labinot Berisha nga radhët e LDK-së si anëtarë i ri që të jap betimin para kuvendarëve.

Para miratimit të rendit të ditës, Kryesuesi i Kuvendit z.Nahit Elshani kërkoj që në rend dite të hyn edhe një pikë që ka të

bëjë me bartjen e mjeteve të mbetura buxhetore nga viti 2013 të barten në vitin 2014. Kryesuesi theksoi se kjo pikë shtesë për rend dite ishte kërkesë e ardhur pas takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe ka rrjedhë si kërkesë e ardhur nga Ministria e Financave. Si e tillë kjo kërkesë hynë si për pikë shtesë e rendit të ditës dhe nga ana e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit miratohet me shumicë votash rendi i ditës i propozuar, bashkë me pikën shtesë e cila kishte të bënte rreth marrjes së vendimit për alokimin e mjeteve nga të hyrat vetanake të pa shfrytëzuara në vitin 2013 për vitin 2014.

Me vërejte teknike dhe sugjerime të vogla për plotësim, anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit kanë miratuar me shumicë votash procesverbalet e mbledhjeve të datës të datës 13.02.2014 dhe 26.02.2014.

Rreth vendimit për bartjen e mjeteve të mbetura buxhetore nga viti 2013 të barten në vitin 2014, fillimisht foli Drejtori i Ekonomisë Z. Lulzim Sylejmani i cili arsyetoj këtë bartje të mjeteve buxhetore në vlerë prej 117,918 euro nga viti 2013 në vitin 2014 për shkak të kërkesës që ka ardhur nga Ministria e Financave që këtë mjete të barten në vitin 2014 me qëllim të mos humben., dhe se komuna i ka borxh këto mjete në Malësi të Vogël ku totali i borxhit është 246.000 euro. Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit kanë potencuar se duhet paguar borxhi paraprak nga ndërtimi i ambulancës në Palluzhë dhe se nuk duhet të paguhet një borxh tjetër nëse nuk kryhet ai

i cili ka mbetur pa u finalizuar. Edhe përkundër kundërshtimeve të opozitës së kjo shumë të mos alokohet në projektin e propozuar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa, me shumicë votash miratohet ky propozim.

Pika e tretë e rendit të ditës rreth informatës mbi obligimet financiare të faturuara dhe të pa faturuara. Rreth kësaj pike, Drejtori i Financave z. Lulzim Sylejmani tregoj për borxhet e qeverisë së kaluar ku tha se obligimet e kontraktuara deri më datë 31.12.2013 janë 6 ,898,000 euro ndërsa të faturuara janë 2,064,239 euro. Duke shtuar më tej se rreth 700.000 euro, qeveria e kaluar ka borxhe nga projektet e kaluara të cilat nuk kanë kode buxhetore.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit kryesisht nga radhët e pozitës kanë kundërshtuar formën dhe mënyrën e shpenzimit të parasë publike nga ish qeverisja lokale e udhëhequr nga ana e AAK-së. Derisa opozita e kundërshtoi një vlerësim të tillë duke mos pranuar borxhet që ka krijuar AAK-ja nga mandati i saj qeverisës të paktën jo në shumën e prezantuar në raportin financiarë të komunës së Rahovecit e cila tashëm udhëhiqet nga PDK-ja në bashkëqeverisje me LDK-në. Sipas opozitës, shuma e borxheve faktike të komunës nuk tejkalon 1 milion Euro dhe totali i obligimeve financiare ndaj Operatorëve Ekonomik (OE) është 2.168.000 euro.

Pika e katërt e rendit të ditës kishte të bënte rreth shqyrtimi të Komisionit për ndryshimit dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Rahovecit.

Lidhur me pikën e katërt të rendit të ditës e cila kishte të bënte rreth shqyrtimit të punës së Komisionit për ndryshimin e dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Rahovecit, anëtarëve të kuvendit i është ofruar një draft fillestar mbi ndryshimet e mundshme të Statutit.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës ndër të tjera kërkuan që në Statutin e Komunës së Rahovecit të specifikohen emrat e vendbanimeve të komunës, si dhe dhënien e kompetencave Kryetarit të Komunës për të shtuar apo zvogëluar numrin e Drejtorive komunale. Këto propozime u kundërshtuan nga disa këshilltarë të AAK-së , të cilët arsyetuan se emrat e vendbanimeve duhet të jenë në përputhje me Ligjin që e rregullon këtë çështje, sepse në disa fshatra banorët i kanë ndryshuar emrat e vendbanimeve të tyre, e që nuk mund të përfshihen në statut. Po ashtu u bë vërejtje edhe rreth shtimin të kompetencave të kryetarit për mënyrën e funksionimit të drejtorive komunale.

Kryesuesi i Komisionit për ndryshimin e Statutit të Komunës së Rahovecit z. Qazim Qeska, në emër të Komisionit tha se ndryshimet janë kryesisht kozmetike, mirëpo ndryshimet e përgjithshme e bëjnë të domosdoshëm rishikimin e Statutit të komunës. Ndryshimet janë formale dhe nuk preket esenca e

statutit. Në bazë të propozimeve që mund të dalin nga Kuvendi, këto propozime do të dalin në diskutim publik si dhe pas kësaj përpilohet edhe Rregullorja e organizimit të brendshëm në komunë.

Pas këtyre debateve u vendos që të miratohet me shumicë votash plotësimi dhe ndryshimi i statutit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhe të hudhet në debat publik. Kjo u miratua me shumicë votash ku 9 ishin kundër këtij ndryshimi.

Kuvendi i Komunës së Rahovecit në seancën e mbajtur në muajin mars ka themeluar edhe Këshillin Komunal për Sigurinë e Bashkësive(KKSB), vendim ky që derivon nga neni 7 Ligjit për Policinë dhe nenit 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativë nr. 27/12- 03/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës.

Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 të MPB-së dhe UA 03/2012 të MAPL-së nenin 9 të këtij udhëzimi në kuadër të detyrave dhe përgjegjësit e Kryesuesit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi janë ; brenda tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi të këtij udhëzimi administrativ, përmes mediave publike, fton komunitetet përkatëse për të bërë propozimet e anëtarëve të tyre në KKSB, 1.2. në bazë të propozimeve të komuniteteve përkatës e përgatit listën e anëtarëve të KKSB-së duke përfshirë të gjithë akterët, ashtu siç është përcaktuar

në nenin 4 të këtij udhëzimi administrativ dhe të njëjtën listë e dërgon në Kuvendin Komunal për miratim⁴.

Bazuar në dispozitat e neneve përkatëse të udhëzimit administrative për këshillat për siguri në bashkësi , Kryetari i Komunës së Rahovecit ka shkelur procedurat në emërimin e anëtarëve, duke mos krijuar kushte të favorshme për gjithë palët e mundshme të interesuara për të qenë pjesë e këtij këshilli ngase nuk është bërë fare ftesë përmes mediave publike për të marrë propozimet eventuale për këtë këshillë.

Sipas dispozitave ligjore, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi duhet të përbëhet nga Kryetari i Komunës, Kryetari i Komunës (që do të jetë dhe Kryesues i KKSB-së), Komandanti i Stacionit të Policisë në komunë, nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare, nga një përfaqësues të secilit komunitet (që do të propozojë Kryetari i Komunës), kryesuesi i komitetit për komunitete, zyrtari për barazi gjinore, drejtori i drejtorisë për arsim, kryetari i këshillit të prindërve të arsimit, një përfaqësues i FSK-së, një përfaqësues i secilit këshill lokal për siguri publike, kryesuesi i ekipit veprues për siguri në bashkësi, një përfaqësues nga sektori i emergjencave civile komunale, përfaqësuesi i zyrës komunale për komunitete dhe

⁴ Neni 9 i Udhëzimit Administrativ . 27/2012 të MPB-së dhe UA 03/2012 të MAPL-së, <http://ëëë.mpb-ks.org/repository/docs/UA%20NR.%2027-2012%20MPB%20-%2003-2012%20MAPL%20per%20Keshillat%20Komunale%20per%20Siguri%20ne%20Bashkesi.pdf>

kthim, një përfaqësues nga OJQ, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.

Me shumicë votash miratohet formimi i këtij Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB).

Pika tjetër e cila u shqyrtuar në kuadër të punimeve të seancës ishte edhe vendimi për formimin e Komisionit për emërimin e rrugëve, shesheve, institucioneve dhe vendeve tjera publike në komunën e Rahovecit.

Kuvendi i Komunës së Rahovecit fillimisht kishte propozuar që ky komision në vetë ti ketë 11 anëtarë miro gjatë shqyrtimit të kësaj pikë të rendit të ditës nga ana e anëtarëve është propozuar që komisioni në vete ti ketë të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Rahovecit. Nga kjo, rezultoi që Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ka propozuar rritjen e numrit të anëtarëve nga 11 në 13 duke përfshi të gjitha subjekte politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës së Rahovecit dhe një përfaqësues nga Shoqëria Civile.

Prandaj në bazë të këtij propozimi u bë edhe plotësimi i Komisionit Komunal për emërtim të rrugëve, shesheve dhe institucioneve komunale, . tani në këtë komision janë të përfaqësuara të gjitha subjektet politike që kanë anëtarë në Kuvend, si dhe nga shoqëria civile. Në këtë Komision u propozuan këta anëtarë të rinj;), Fatmir Iska (AAK), Selim Duraku LDK , Astrit Thaçi (PDK), Xhihad Vuçiterna (PD) ,

Azbi Gashi (VV) , Sinan Ejupi (AKR) si dhe Bahtjar Hoti (LB).

Projekt vendimi për formimin e Komisionit Komunal për ndarjen e bursave për student në komunën e Rahovecit, kaloi pa ndonjë debat mirëpo janë propozuar anëtarët e Kuvendit të Komunës së kush nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit do të jetë në përbërje të këtij komisioni komunal.

Ne bazë të nenit 6 të Rregullores komunale për ndarjen e bursave thuhet se “bursat për studentët do të ndahen nga Komisioni i formuar me Vendim Kuvendit të Komunës. Komisioni për ndarjen e bursave përbëhet prej 5 anëtarëve. a) Tre anëtar të propozuar nga Kuvendi Komunal, b) Një anëtar i propozuar nga Kryetari i Komunës, c) Një anëtar do të jetë nga shoqëria civile të cilin e propozon Kuvendi i Komunës⁵.

Konform kësaj dispozite ligjorë, anëtarët nga Kuvendi i Komunës të cilët janë propozuar që të jenë pjesë e këtij komision janë: Marigona Berisha (LDK), Artan Zenuni (AAK), Qazim Qeska (PDK), Femi Isma nga Shoqëria Civile (sekretar i shoqatës familjet e dëshmorëve të UÇK) derisa ekzekutivi komunal përkatësisht Kryetari i Komunës do të delegonjë përfaqësues në vijim duke mos dhënë emër konkret gjatë kësaj seance se kush nga ekzekutivin komunal do ta përfaqëson në këtë komision.

⁵ Neni 6 i Rregullores për ndarjen e bursave, <http://kk.rks-gov.net/rahovec/getattachment/Municipality/Assembly/Regulations/Rregull-ore-per-Bursa.pdf.aspx>

Numri i bursave komunale për studentë të komunës së Rahovecit për vitin 2014 do të jetë 80, numër ky i cili u kërkua nga anëtarët e Kuvendit të Komunës që të rritet mirëpo sipas mundësive buxhetore kjo gjë tani për tani është e pamundur. Vendimi për formimin e Komisionit Komunal për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Rahovecit është miratua unanimisht nga anëtarët të pranishëm gjatë punimeve të seancës.

Pika e tetë e rendit të ditës e cila kishte të bënte me projekt vendimin për krijimin e servitutit sendorë në pronën komunale në favor të Kompanisë Upwind International GmbH, dega në Kosovë. Lidhur me këtë projekt vendim, të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit në mënyrë unanime votuan pro me qëllim të krijimit të drejtës së servitutit në pronësi komunale për kompaninë e cila planifikon të investojë në bjeshkën e Zatriqit në prodhimin e energjisë elektrike nga era.

Krijimi i së drejtës së servitutit sendorë në pronën komunale (shtetërore), në favor të Kompanisë Upwind International GmbH, dega në Kosovë – Prishtinë, bëhet në ngastrën kadastrale nr. 493, në vend të quajtur “Virbe – Vorret”, në sipërfaqe prej 1775 m², nga çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. 98 z.k. Zatriq, pronë e komunës së Rahovecit.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit në mënyrë unanime votuan projekt vendimin për pregaditjen e projektit teknik për zgjerimin e sistemit të ujitjes për fshatrat Bratatin dhe Vërnjak ku do të përfshihen 73 ha dhe të fshatrave Nagac, Hoçë e Vogël dhe Brestovc në sipërfaqe prej 198 ha. Ky vendim u përkrahë pas arsyetimit të Drejtorit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural z.Lulzim Hasku ku potencoi se kjo kërkesë duhet të miratohet nga ana e Kuvendit të Komunës meqë një gjë e tillë kërkohet nga MBPZHR dhe kjo vlerë e projektit duhet të arrijë 354.520 € dhe i njëjti projekt mbështetet nga MBPZHR

Në pikën e dhjetë të rendit të ditës në pyetjet e këshilltarëve si pyetje që i janë drejtuar ekzekutivit komunal ishin: mungesa e ndërtimit të Sallës së Sporteve nga ana e Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, mungesa e pagesës së mëditjeve për anëtarët e Kuvendit të Komunës, koha e marrjes së bursave për studentët etj.

Në seancën e Komunës së Rahovecit, gjatë punimeve është përdorë gjuhë jo-parlamentare dhe fyese për anëtarin e këtij institucioni nga ana e drejtorit komunal. Përdorimi i gjuhës jo parlamentare dhe fyese në kuvendin e komunës së Rahovecit tregon për nivelin e ultë të kulturës institucionale. Me këtë rast KDI i bënë thirrje anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të përmbahen dhe të respektojnë diversitetin e mendimeve dhe ideologjitë partiake dhe vetë institucionin e

Kuvendit të Komunës së organ më i lartë i vetëqeverisjes lokale.

- **Dragash**

Kuvendi i Komunës së Dragashit ka mbajtur seancën e rregullt të saj (20.03.2014) gjatë së cilës ka trajtuar këto çështje; shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit nga seanca e kaluar e Kuvendit; shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor Komunal për komunën e Dragashit 2013-2023, shqyrtimi dhe miratimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për komunën Dragashit 2013-2018, shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit për themelimin e Komisionit për Ankesa lidhur me dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, dhe shqyrtimi i



propozimeve për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në 2 parcela të KK Dragash: Parcela kad. Nr.538, dhe Parcela kadastrale nr.782.

Me propozim të kryesuesit të kuvendit, për arsye të mungesës së informacionit është hequr nga rendi i ditës propozimi i parë nga pika e gjashtë e rendit të ditës, dhënia në shfrytëzim e pronës komunale në parcelën kad. Nr.538. Për rend të ditës votimi ka rrjedhur unanimisht.

Deri sa në pikën e parë të rendit të ditës ishte paraparë që të jetë fjala përshëndetëse e z. Ulrich Biffar, ushtrues detyre i drejtorit të Zyrës Rajonale të OSBE-së në Prizren.

Edhe sa i përket pikë së dytë me radhë e që kishte të bënte me procesverbalin nga seanca e kaluar dt. 25.02.2014 vërejtje në lidhje me të paraqiti anëtari nga radhët e BD-së z.Nexhat Isufi. Votimi rreth procesverbalit rrodhi me 23 votuan për dhe 1 kundër.

Pika e tretë me radhë e cila zgjoi debat më të gjatë në këtë mbledhje ishte ajo rreth mos përfshirjes së vërejtjeve gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2013-2023 të komunës së Dragashit, hartuar nga zyra e UNDP-së, i cili që nga 4 prilli deri me 4 qershor 2013 i është nënshtruar edhe diskutimit publik. Anëtarët e kuvendit të komunës nga radhët e LDK-së si Halim Shemsedini, Bahtjar Berisha e Kapllan Fetahu, gjatë diskutimit të tyre kanë shprehur brengën e tyre se gjatë leximit të tekstit të këtij plani kanë vërejtur se edhe më tej ka vazhduar praktika e më hershme e mos inkorporimit të vërejtjeve të tyre. Anëtarët e LDK-së e quajtën si të pa pranueshëm mënyrën se si është hartuar ky dokument, edhe pse për hartimin e tij janë harxhuar shuma të mëdha parash, ndërsa materia brenda saj lë shumë për të dëshiruar.

Edhe anëtarët tjerë nga radhët koalicionit boshnjak Vakaf, Velid Haxhisin e Sherif Aga kanë pasur vërejtje rreth mospërfshirjes së investimeve në aksin rrugor Restelicë-Strezimir, me ku me këtë rast kërkesat banorëve të kësaj ane nuk janë marrë parasysh në lidhje me hapjen e një pike kufitare me Maqedoninë. Një çështje mjaftë e rëndësishme ishte edhe kërkesa e Halim Shemsedinit nga LDK-ja dhe Emin Kolloni nga PDK-ja të cilët kërkuan nga kryetari i komunës z.Salim Jenuzi që në bashkëpunim me Qeverinë e Vendi të shikojnë vijën e demarkacionit me Maqedoninë, ngase bazuar

në informacionet që kanë nga tereni kësaj komune i është aneksuar një pjesë e mirë e territorit.

Pas zotimeve të kryesuesit të Kuvendit të Komunës z. Shaban Shabani dhe kryetarit të komunës z. Salim Jenuzi, se vërejtjet e dhëna do të jenë pjesë përbërëse e këtij dokumenti, Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023 është miratuar me vota unanime.

Pika e katërt e rendit të ditës e cila kishte të bënte rreth shqyrtimit dhe miratimit të Planit të Veprimit në Mjedis për komunën e Dragashit 2013-2018, plan ky i cili po ashtu është përgatitur nga UNDP-ja dhe ministria e Mjedisit, e i cili është edhe pjesë përbërëse e PZHK-së e ka shtyrë Bahtjar Berishën nga LDK-ja që të kërkoj nga organet përgjegjëse që të bëjnë më shumë rreth dhe të merren më seriozisht me këtë pasi që gjendja në mjedis është tejet e keqe, ku siç tha ai ne vazhdimisht kemi bërë shkelje pasi që nuk ju kemi përmbajtur asnjë plani e rregullore, sidomos largimin e ujërave të zeza nëpër lumenj si dhe të bëhet rregullimi dhe përfundimi i të gjitha kanalizimeve nëpër ato fshatra që ende nuk janë përfunduar.

Rekomandime rreth këtij Plani dha edhe Emin Kolloni (PDK), i cili kërkoi që sa më parë të merren masa për mbrojtjen e ambientit sidomos me grumbullimin e mbeturinave, të bëhet shpërndarja e kontejnerëve, si dhe të shqyrtohen mundësitë në zbritjen e tarifës për mbeturinat prej 4.50 euro për të gjitha ekonominë familjare pasi që disa familje e kanë të pa mundur dhe tepër të vështirë ta përballojnë këtë çmim. Kërkesë për zbatimin sa më parë të këtij Plani paraqiti edhe Samidin

Xheladini (LDK), i cili kërkoi që të jetë prioritet kryesor futja e të gjitha fshatrave në sistemin e ujit të pijes si dhe futjen në sistemin e mbeturinave, pasi që ata të cilët nuk po paguajnë janë edhe ndotësit më të mëdhenj të ambientit pasi që mbeturinat e tyre po i hedhin kudo. Me vërejtje dhe me vota unanime është miratuar Plani i Veprimit në Mjedis.

Gjatë kësaj mbledhje tek pika e pestë me radhë, në bazë të nenit 9 pika 4 të Ligjit nr.04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale në bazë të nenit 3 të rregullores të Qeverisë të Kosovës nr.23/13 për caktimin e procedurave dhe dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale, dhe me rekomandimin e KPF-së që ky komision të përbëhet nga pesë anëtarë, këshilltarët e kuvendit të komunës Dragashit votuan në mënyrë unanime lidhur me këtë komision. Anëtarët e këtij komisioni janë: Emin Kolloni (LDK), Ymridin Krasniqi (AAK), Kapllan Fetahu (LDK), Zinaida Elmazi (VAKAT) dhe Hajrudin Hodza (CDU).

Derisa Luljete Berisha (AAK) iu tërhoqi vërejtjen kolegëve të tyre anëtarë të Kuvendit, për siç tha ajo mos përfaqësim të femrës në komisione të ndryshme duke i akuzuar këta të fundit edhe për diskriminim gjinor.

Pika e gjashtë me radhë e që për qëllim pati shqyrtimin e propozimit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, të parcelës kad. nr. 782 në Komunën e Dragashit, lidhur me vendosjen e një barake montazh në sipërfaqe prej 12 m/2 e cila do të shërbente si zyre për dhënien e ndihmës juridike për qytetarët. Propozimi nga ana e kryetarit të komunës, kushtet e ankandit dhe arsyet për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të

pronës së paluajtshme komunale janë paraqitur në formë të shkruar para anëtarëve të kuvendit të komunës.

Rreth kësaj temë reagoi anëtari nga radhët e LDK-së Halim Shemsedini i cili tërhoqi vërejtjen se nuk është mirë të hapet problemi i dhënies së pronave të komunës për baraka pasi që ne në kohën e më hershme si komunë vet kemi marrë aksion për heqjen e tyre për arsye të lirimimit të hapësirave publike, po ashtu kjo do të ndikonte që qytetarët të vërshojnë për kësi lloj kërkesash edhe pse ne si komunë kemi ngecje në mbledhjen e qirave (borxhet).

Ndërsa Emin Kolloni (PDK) reagoi lidhur me vlerën e çmimit fillestar të ankandit prej 1€ për m², çmim ky tejet i ulët dhe jashtë çdo norme. Pro këtij vendim ishin 14 anëtar, 5 kundër dhe 5 abstenime.

- **Mamushë**

Kuvendi i Komunës së Mamushës ka mbajtur seancën e radhës (28.03.2014) gjatë së cilës ka trajtuar këto çështje: shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; shqyrtimi dhe miratimi i mbledhjes së rendit të ditës; marrja nën mbrojtje e tokave Publike dhe të bëhen matjet kadastrale; bartja e të hyrave vetanake nga viti 2013 ne 2014, ne projektin “Siguria në qytet-Kamera” shuma prej 15 mijë euro, vënia në diskutim publik e Planit Lokal për Veprim në Mjedis, miratimi i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës, vendimi për formimin e Përmendores së Dëshmorëve të Çanakkalasë dhe të ndryshme.

Në fillim të senacës, Kryesuesi i kuvendit të komunës së Mamushës informoi anëtarët e Kuvendit të Komunës se Komiteti për Politik dhe Financa ka dalë me rekomandim për ndryshim të rendit të ditës duke shtuar edhe dy pika tjera për rend dite si: miratimin e Rregullore së punës së Kuvendit të Komunës si dhe vendimi për ndërtimin e përmendores së Dëshmorëve të Çanakkalasë që kanë rënë në luftë në shtetin Turk.

Fillimisht para rendit të ditës si pikë e parë, pa vërejtje dhe në mënyrë unanime është miratuar procesverbali nga seanca e kaluar.

Halim Sadiku (PDK) kërkoi që përgjegjësit në komunë ta kenë parasysh që me ndërtimin e kësaj Përmendore të përfshihen edhe martirët që kanë rënë Dëshmor në komunën e Mamushës gjatë luftës së fundit e cila ka ndodhur në Kosovë.

Ndërsa sa i përket rendit të ditës, Abdulhadi Krasniqi nga KDTP-ja kërkoi që të hiqen nga rendi i ditës pika 3, marrja nën mbrojtje e tokave Publike dhe të bëhen matjet kadastrale me arsyetimin së Kuvendi i Komunës së Mamushës nuk duhet të merr vendim për këtë çështje si dhe pika 4 dhe 5 për arsye të mungesës së informacionit.

Vërejtje – Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Mamushës nuk e përfilli kërkesën e anëtarit të KDTP duke mos e proceduar as për votim kërkesën e anëtarit të KDTP-së, ku në shenjë revolte të katër anëtarët e kësaj parti lëshuan sallën. Po ashtu nga Kryesuesi nuk u procedua për votim as rendin e ditës duke kaluar menjëherë në shqyrtim të pikës së tret me radhë.

Lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës, z.Jalcin Mazrek, Drejtorë i Drejtorisë së Kadastrit foli para anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Mamushës për rëndësinë e identifikimit të pronave (parcelave) komunale. përkatësisht, marrjen e vendimit për identifikimin e tokave publike të komunës së Mamushës dhe të bëhen matjet kadastrale të tyre, u diskutua si informatë Lidhur me këtë çështje informatë për anëtarët e kuvendit paraqiti drejtori i kadastrës z. Jalcin Mazrek i cili shpalosi rëndësinë e identifikimit të pronave (parcelave) komunale të cilave pastaj do tu bëhen matjet kadastrale dhe kështu komuna e Mamushës do të kishte përparësi në përballimin dhe trajtimin e duhur të pasurisë komunale. Me identifikimin dhe matjen kadastrale të pronave ne si drejtori mundemi dhe kemi kompetenca për ta bërë një gjë të tillë, por ne kemi dashur që të kemi edhe vendimin e asamblesë potenco ai. Votimi unanim (9 anëtar të pranishëm).

Edhe në pikën e katërt të rendit të ditës, me vota unanime dhe me përkrahje të të gjitha subjekteve politike që ishin të pranishme në asamble, është marrë vendim për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2013 në vitin fiskal 2014, në shumën prej 15 mijë euro mjete këto që do të përdoren për projektin “Siguria në Qytet” vendosja e kamerave.

Ndërsa në pikën e pestë me radhë është marrë vendim për vënien në diskutim publik të Planit Lokal për Veprim në Mjedis, plan ky i cili po realizohet nga komuna e Mamushës në bashkëpunim me REC, e që është në fazën e fundit të pregaditjeve. Shuma e këtij projekti është 60 mijë euro, ku nga këto mjete 20 mijë euro do ti ndajë komuna e Mamushës

ndërsa 40 mijë euro REC. Votimi është marrë unanimit nga të gjithë anëtarët e asamblesë së Mamushës.

Derisa për miratimin e Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Mamushës, si pik e gjashtë e rendit të ditës, nuk është zhvilluar ndonjë debat dhe në mënyrë unanime nga anëtarët e Kuvendit është miratuar ajo e vjetra siç ka qenë në vitin 2013.

Në pikën e shtatë të fundit me radhë që kishte të bënte me vendimi për ndërtimin e Përmendores së Dëshmorëve të Çanakkalasë, ku si datë përkujtimore ka 18 marsin, kërkesë kjo e cila erdhi nga KFORi Turk dhe Tika si shenjë respekti për të gjithë dëshmorët e rënë në betejën e Çanakkalasë në Turqi të cilët prejardhjen e kishin nga Kosova. Votimi unanim.

Vlen të potencohet se Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Mamushës nuk është treguar në nivel të detyrës duke shkel Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës. Ai në të shumtën e rasteve nuk tregon respektimit të kohës së përcaktuar në Rregulloren punës në respektimin e kohës së diskutimit dhe shprehjen e mendimeve nga ana e anëtarëve lidhur me pikat e rendit të ditës. Ai po ashtu në një rast në fund të mbledhës tek pika e fundit me radhë tek të ndryshme, fjalën ia kishte dhënë një qytetari i cili kishte kërkuar që ti paraqet shqetësimet e banorëve në rrugën të cilën tash e sa vite është e pa rregulluar.

Me të marrë fjalën ky qytetarë debati është zhvilluar në mes të Kryesuesit, anëtarëve të kuvendit dhe qytetarëve të pranishëm, pa ndonjë rend e rregull duke ulë reputacionin e Kuvendit të Komunës si institucion i vetëqeverisjes lokale.

- **Raportimet Financiare në Kuvendin e Komunës për vitin fiskal 2013**


Raportimet financiare të qeverisë lokale karshi kuvendit si institucion më i lartë i vetëqeverisjes lokale duhet të jenë të rregullta dhe periodike në bazë të legjislacionin në fuqi. Në këtë kontekst dhe bazuar në legjislacioni në fuqi, Komunitat e regjionit të Prizrenit si datë të fundit të raportimit të tyre financiar karshi kuvendit të komunës kanë pasur datën 31 mars për shqyrtimin e raporteve financiare të vitit fiskal 2013.

Jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik, Ministri do të përgatitë dhe dorëzojë Qeverisë, për miratim dhe dorëzim në Kuvend, një raport përfundimtar përmbledhës të buxhetit për vitin e kaluar fiskal dhe dy vitet paraprake fiskale, i cili përfshin: a) një raport mbi të ardhurat dhe shpenzimet, i cili paraqet të dhëna krahasimore për këto vite në mes tjerash edhe lidhur me: një mbishikim të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike, një mbishikim të ndonjë deficiti ose suficitit buxhetor si dhe mënyra se si është financuar deficit ose si është investuar suficiti; të ardhurat faktike, të identifikuar sipas llojit, të organizatave buxhetore të krahasuara me parashikimet përkatëse në cilat janë përfshirë në buxhet; një llogaritje të plotë të aseteve të cilat mbahen nga organizatat buxhetore në fund të vitit fiskal; dhe një vlerësim të të gjitha detyrimeve kontingjente, duke përfshirë një vlerësim të riskut të këtyre detyrimeve kontingjente.

Kryetari i komunës duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal një raport përfundimtar përmbledhës buxhetor i cili

përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 46.1, sikur që aplikohen ato për komunën përkatëse⁶.

Në kuadër të monitorimit të Kuvendeve të Komunave të regjionit të Prizrenit, një mos respektim të afatit kohorë në raportimet financiarë të vitit paraprak fiskal, nuk kanë kryer Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Malishevës nuk kanë respektuar një obligim të tillë ligjorë i cili detyron që të raportojnë për vitet paraprake fiskale në kuvendin e Komunës jo më vonë se 31 marsi të vitit kalendarik.



KDI i bënë thirrje Kryetarëve të Komunave të regjionit të Prizrenit që të respektojnë dispozitatat ligjore në raportimet financiare në Kuvendin e Komunës përkatëse sipas dispozitave ligjore të ligjit Nr. 04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr. 03/L-221 dhe ligjin Nr. 04/L-116. Po ashtu, KDI qysh tani i bënë thirrje

⁶ Neni 46 I Ligjit Nr.04/L-194 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet Nr.03/L-221 dhe ligjin Nr.04/L-116

që konform të këtij ligji, në seancën e muajit prill të procedojmë edhe me raportin tre mujor financiarë me qëllim të respektimit të obligimeve që dalin në kuadër të këtij ligji.

- **Shpenzimet enorme të komunës së Prizrenit në disa kategori buxhetore**

Në kuadër të analizës së raportit financiarë të vitit fiskal 2013 të Komunës së Prizrenit, KDI konsideron që disa shpenzime në disa kategori apo kode buxhetore janë enorme dhe jashtë çdo standardi për situatën ekonomiko-financiare në komunën e Prizrenit”.

Lidhur me këtë, në kodin buxhetorë 13780, qeveria komunale e Prizrenit, në vitin 2013 ka shpenzuar 133.345 euro karburant për vetura. Me një përlllogaritje të vogël kjo qeveri në vitin e kaluar ka shpenzuar 365 euro në ditë karburant për vetura ($133.345/365=365$ euro), pra shpenzime ditorë duke llogaritur çdo ditë të vitit kalendarikë përfshirë këtu edhe ditët e vikendit dhe festat zyrtare.

Me një përlllogaritje të shumës prej 365 euro si shpenzime ditorë për fuqinë blerëse të benzinës apo naftës del se kjo qeveri në vitin e kaluar ka shpenzuar 304 litra derivate në ditë

($365/1.2=304$ litra). Nëse shpenzimi mesatarë për një veturë në 100 km është afërsisht 8 litra benzinë atëherë kjo qeveri në vitin 2013 ka kaluar 3.800 km në ditë ($304/8*100=3800$ km) apo shprehu në baza vjetore kjo qeveri ka shpenzuar 110.930 litra derivate në vit ($304*365=110.960$ litra derivate), nëse shpenzimi mesatarë për një veturë në 100 km është mesatarisht 8 litra benzinë/naftë atëherë kjo qeveri në vitin 2013 ka kaluar 1.387.000 km për një vit të tërë fiskal duke llogaritur vikendet dhe festat zyrtare si ditë aktive të punës ($110960/8*100=1387000$ km).

Edhe në kodin buxhetorë 14010 në kategorinë e shpenzimeve për mallra, qeveria lokale e Prizrenit ka shpenzuar shumë prej 58,360 euro për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve të komunës.

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) i bënë thirrje kryetarit të Komunës së Prizrenit që të shkurtojë shpenzimet në disa kode buxhetore (si në shpenzimet e derivateve për veturë, shpenzimet telefonike Vala, në mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve etj), dhe të kujdeset që paraja e qytetarëve prizrenas të shpenzohet në mënyrë efikase dhe me ekonomikitet dhe në dobi të qytetarëve mbi bazën e parimit të mirëqeverisjes.

Shpenzimet sipas kategorive		Periudha		
		Prej 01.01.2013	Deri 31.12.2013	
Kategoria	Planifikimi	Shpenzimet	Diferenca	Indexi
Pagat	1,458,257.00	1,414,729.49	43,527.51	97.02 %
11100 Pagat neto permes listes se pagave		1,228,621.67		84.25 %
11120 Tatimi I ndaluar ne te ardhura personale		51,361.96		3.52 %
11130 Kontributi per pension I punetorit		67,366.50		4.62 %
11140 Kontributi per pension I punedhenesit		67,366.50		4.62 %
11150 Pagesa per sindikat		12.86		0.00 %
Mallrat e sherbimet	1,255,723.00	992,672.86	263,050.14	79.05 %
13100 Shpenzimet e udhetimit		0.00		0.00 %
13130 Shpenzimet e udhetimit brenda vendit		5,079.30		0.40 %
13140 Shpenzimet e udhetimit Jasht vendit		29,422.17		2.34 %
13141 Meditjet e udhetimit zyrtar jasht vendit		15,760.78		1.26 %
13320 Shpenzimet tjera telefonike-Vala 900.		37,875.70		3.02 %
13330 Shpenzimet postare		13,233.68		1.05 %
13410 Sherbimet e arsimit dhe trajnimit		730.00		0.06 %
13450 Sherbime,shtypje -jo marketing		20,311.00		1.62 %
13460 Sherbime kontraktuese tjera		208,065.11		16.57 %
13470 Sherbime teknike		9,931.92		0.79 %
13480 Shpenzimet e antarsimit		20,953.62		1.67 %
13501 Mobilje deri 1000 €		720.00		0.06 %
13503 Kompjutera deri 1000 €		945.00		0.08 %
13505 Makine fotokopjuese		1,298.00		0.10 %
13509 Paisje tjera		15,819.15		1.26 %
13610 Furnizim per zyre		109,592.80		8.73 %
13620 Furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)		18,602.74		1.48 %
13630 Furnizime mjeksore		95.80		0.01 %
13640 Furnizime pastrimi		33,406.87		2.66 %
13650 Furnizim me veshmbathje		3,060.00		0.24 %
13660 Akomodim		12,179.87		0.97 %
13750 Qymyr		12,738.00		1.01 %
13760 Dru		6,448.68		0.51 %
13770 Derivate per gjenerator		71,782.67		5.72 %
13780 Karburante per vetura		133,345.42		10.62 %
13950 Rregjist.kereve		4,220.00		0.34 %
13951 Sigurimi I automjeteve		15,415.36		1.23 %
13952 Taksat e rregjistrimit te kereve		422.00		0.03 %
13953 Sigurimi ndertesave dhe tjera		4,497.00		0.36 %
14010 Mirmabajtja dhe riparimi I automjeteve		58,360.37		4.65 %
14020 Mirmajtja e ndertesave		26,984.30		2.15 %

Kategoria		Periudha			Indexi
		Prej	Deri	31.12.2013	
		Planifikimi	Shpenzimet	Diferenca	
14040	Mirmbajtja e teknologjis informative		1,404.30		0.11 %
14050	Mirmbajtja e mobiljeve dhe paisjeve		3,474.50		0.28 %
14210	Reklammat dhe konkurset		8,037.25		0.64 %
14230	Shpenzimet per informim publik		22,850.40		1.82 %
14310	Drekat zyrtare		22,885.27		1.82 %
14310-1	Shpenzime për manifestime te ndryshme		24,856.43		1.98 %
14410	Vendimet e Gjykatave		17,867.40		1.42 %
Shpenzimet komunale		475,244.00	442,563.60	32,680.40	93.12 %
13210	Shpenzimet e rrymes		376,239.24		79.17 %
13220	Shpenzimet e ujit		54,665.42		11.50 %
13230	Shpenzimet mbeturinave		652.80		0.14 %
13250	Telefoni - PTK me fatura		11,006.14		2.32 %
Subvencionet		345,979.00	320,741.20	25,237.80	92.71 %
21110	Subvencionet per entitete publike		259,343.53		74.96 %
21200	Subvencionet per etinete jo publike		61,397.67		17.75 %
Shpenzimet kapitale		10,890,899.00	9,740,633.06	1,150,265.94	89.44 %
31110	Ndertesat e banimit		0.00		0.00 %
31120	Ndertesat administrative afariste		92,381.74		0.85 %
31123	Objektet Kulturore		67,746.20		0.62 %
31124	Objektet Sportive		756,736.70		6.95 %
31230	Ndertimi i rrugeve		5,630,729.41		51.70 %
31240	Ndertimi i Trotuareve		4,100.00		0.04 %
31250	Kanalizimi		693,337.84		6.37 %
31260	Ujsjellsi		194,480.00		1.79 %
31620	Mobilje		9,730.00		0.09 %
31690	Paisje te tjera		110,237.96		1.01 %
31700	Automjete		13,332.46		0.12 %
31900	Kapital tjetër		2,167,820.75		19.90 %
Gjithsej		14,426,102.00	12,911,340.21	1,514,761.79	89.50 %